AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

FONDI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS

QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN

NEWSLETTER
E DIASPORËS

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,
DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#21

## Së shpejti aplikacioni “Diaspora Shqiptare”

Të gjithë shqiptarët kudo gjenden shumë shpejt do të kenë mundësi të njihen në kohë reale me gjithçka ndodh në Diasporën Shqiptare. Kjo, falë aplikacionit më të ri “Diaspora Shqiptare”. Synimi i këtij aplikacioni është që të ofrojë informacion të plotë për gjithçka ndodh në “Diasporën Shqiptare”, të pasqyrojë aktivitetet e komunitetit shqiptar në çdo vend e mbi të gjitha të jetë pikë referimi për të gjithë shqiptarët kudo janë. Aplikacioni “Diaspora Shqiptare” do të jetë një platformë aktive për të gjithë veprimtarinë e Këshillit Koordinues të Diasporës, i cili përbëhet nga 15 përfaqësues të komunitetit shqiptar në botë.

Nëpërmjet këtij aplikacioni do të vijnë te ju lajme, analiza, ide, sugjerime dhe komente lidhur me realitetin shqiptar brenda dhe jashtë Shqipërisë. Nëpërmjet kategorive të përzgjedhura mund të gjeni informacionin që ju nevojitet: aktualitet, histori suksesi në fusha të ndryshme, kulturë, sport etj. Ajo çka e bën të veçantë këtë aplikacion është fakti se për herë të parë shqiptarët kanë një hapësirë virtuale të përbashkët ku mund të informohen për gjithçka ndodh në komunitetin shqiptar anë e mbanë botës.

https://www.youtube.com/watch?v=a_lQsbmiZ5c




## Ndryshohet ligji / Bashkitë, zyra për Diasporën dhe migracionin

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi propozimin e Këshillit të Ministrave për ndryshim dhe disa shtesa në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Kjo është një nismë e Ministrit të Shtetit për Diasporën. Në çdo bashki do të ngrihet një strukturë e veçantë për çështjet e Diasporës dhe migracionit që do të ketë si fokus forcimin e komunikimit dhe marrëdhënieve me komunitetin e shqiptarëve në Diasporë.Gjithashtu do të bëjë të mundur nxitjen e organizimeve, brenda dhe jashtë vendit, për mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm në ndihmë dhe mbajtjen e komunikimit dhe forcimin e marrëdhënieve me Diasporën shqiptare.

Në këto zyra të posaçme prioritet do të jetë dhënia e ndihmës dhe e informacionit për çështje që lidhen me fitimin e shtetësisë shqiptare. Gjithashtu do të ofrohet informacion për të interesuarit nga Diaspora dhe migracioni për legjislacionin shqiptar në fushën e investimeve, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për çështjet e investimeve. Fokus i këtij ligji është nxitja e politikave shtetërore për zhvillim e raporteve me Diasporën duke nxitur bashkëpunim, mbështetjen dhe mbrojtjen e të drejtave e të gjithë shqiptarëve jashtë vendit. Ky ligj është në harmoni dhe me frymën e standardeve ndërkombëtare të konsoliduar në një sërë aktesh si: Karta e OKB-së, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike etj.




## Drejtoresha e AKD-së takohet me zyrtarë të shtetit gjerman



Në Gjermani, drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Etleva Kondi zhvilloi një takim pune me z. Burkhard Jasper, anëtar i parlamentit të shtetit në Landin e Saksonisë së Ulët, si dhe përfaqësues të tjerë të lartë të shtetit gjerman. Gjatë këtij takimi ajo i njohu ata me Politikat Shtetërore për Diasporën, punën e institucionit me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e bashkëpunimin me të gjithë shqiptarët nëpër botë. Gjithashtu znj. Kondi mori pjesë edhe në aktivitetet kulturore kushtuar mësimit dhe ruajtjes së gjuhës shqipe të organizuara në Bashkinë e Osnabrück-ut.

## Miratohet Strategjia Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit dhe Plani i saj i Veprimit 2019 – 2022

Për herë të parë Këshilli i Ministrave ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Qeverisjen e Migracionit dhe Planit të saj të Veprimit 2019 – 2022, e cila është në përputhje me planin e veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018 – 2024. Ky vendim ka si qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e migracionit dhe përafrimin e tij me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare. Integrimi i çështjeve të migracionit në një dokument të vetëm politik erdhi si domosdoshmëri për plotësimin e mangësive të hasura si dhe adresimin e suksesshëm të politikave të migracionit gjatë viteve të kaluara, me qëllim konsolidimin e strukturave të menaxhimit dhe koordinimit të migracionit, pasi deri më tani dokumentet strategjike për migracionit kanë synuar vetëm forcimin e kapaciteteve institucionale.

## Anëtari i KKD-së, Gazmend Kapllani pjesë e Qendrës Irlandeze të Emigrantëve



Anëtari i Këshillit Koordinues të Diasporës, Gazmend Kapllani është zgjedhur në Bordin Këshillues të Qendrës Ndërkombëtare Irlandeze të Emigrantëve, një nga institucionet më active në Boston, që u ofron mbështetje të përditshme refugjatëve dhe emigrantëve të (së paku) 90 vendeve.

## KKD, Ardian Radovicka: Diaspora të eksportojë mendje “të ftohtë”



Z. Ardian Radovicka, anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës tregon një pjesë të rrugëtimit jetësor të tij, nga studimet në universitetin “La Sapienza” në Romë e deri te fillimi i jetës në Kanada. Sipas tij, Diaspora shqiptare duhet të jetë neutrale politikisht dhe të eksportojë para së gjithash, mendje “të ftohtë”, por dhe zemër “të ngrohtë”.

## Turqi / Anëtari i KKD-së Namik Shabi vizitë në disa qendra kulturore



Anëtari i Këshillit Koordinues të Diasporës, z. Namik Shabi, vizitoi disa nga qendrat kulturore në Izmir, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e vlerave dhe të identitetit tonë kombëtar. Vizita e z. Shabi në këto shoqata ndihmon në identifikimin e problematikave brenda komunitetit shqiptar në Turqi me qëllim mbështetjen dhe bashkëpunimin me të gjithë anëtarët e tij.